




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education



RAPORTI VJETOR I PUNËS

Janar – Dhjetor, 2019

-IV- Nr. i prot. 008 Më Dt. 09.01.2020
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Hyrje

Drejtoria për Arsim gjatë gjithë vitit 2019 ka punuar në përputhje të plotë me planifikimet e bëra sipas planit vjetor të punës, përkatësisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë këtij viti. Në këtë raport janë paraqitur synimet, qëllimet, punët, projektet dhe aktivitetet kryesore që kanë karakterizuar DKA-në gjatë gjithë vitit.

Synimet kryesore e DKA-së për vitin 2019 ishin:

- Themelimi dhe funksionalizimi i Ekipit Profesional Vlerësues në kuadër të DKA-së;
- Funksionalizimi i plotë i Ekipeve Profesionale Vlerësuese në secilën shkollë;
- Zgjerimi i stafit të DKA-së me kuadrin e nevojshëm të pedagogëve dhe psikologëve;
- Riparimet dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
- Investimi në ndërtimin e 3 çerdheve për fëmijë;
- Vazhdimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara nga viti 2018;
- Ndërtimi i shkollave të reja;
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me laboratorë dhe teknologji informative.

Qëllime kryesore kishim:

- Ngritjen e cilësisë së procesit edukativo-arsimor në shkollat e të gjitha niveleve;
- Përmirësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të institucioneve edukativo arsimore;
- Zhvillimin e aktiviteteve të shumta kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Funksionimin sa më të mirë të organeve drejtuese të shkollave;
- Ngritjen dhe zhvillimin profesional të kuadrit arsimor.

Objektivat tona të përhershme, që karakterizuan edhe këtë vit, janë:

- Përmirësimi i nivelit të mësimdhënies dhe të nxënësve në të gjitha shkollat;
- Zvogëlimi deri në minimum i mungesave të pa arsyeshme të nxënësve dhe mësimdhënësve;
- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe objekteve parashkollore (çerdheve);
- Riparimet e objekteve shkollore;
- Rregullimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollës;
- Zhvillimi i aktiviteteve të shumta jashtë kurrikulare në nivel shkolle dhe komune;
- Futja në procesin e implementimit të KB dhe KKK për të gjitha shkollat e komunës;
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe me OJQ-të, aksionet vullnetare;
- Integrimi në procesin edukativo-arsimor i të gjithë fëmijëve të të gjitha komuniteteve pa dallim;

AKTIVITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR ARSIM GJATË VITIT 2019

Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë vitit po i paraqesim të përmbledhura sipas periudhave 3 mujore, siç vijon:

- **Në tremujorin e parë Janar- Shkurt-Mars**, është themeluar dhe funksionalizuar Ekipi Profesional Monitorues dhe Vlerësues (EPMV) në kuadër të DKA-së dhe Aktivat Profesionale (AP). Poashtu, gjatë këtij muaji, DKA ka nisur hartimin e projekteve të parapara të fillojnë në vitin 2019. Më 16 Janar, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunim ndërmjet DKA-së dhe Agjencisë për Zhvillim të Luksemburgut (LuxDev), që nëpërmjet projektit KSV/015 të krijohet Sistemi i Informimit për Orientim në Karrierë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Organizuar dhe mbajtëm 3 punëtori me 3 aktive profesionale. Më 23 Janar, në një punëtori të organizuar nga Qendra e Kosovës për Arsim në Prishtinë, lidhur me programin e kësaj qendre dhe organizatës USAID për aplikimin e shkollave në programin ASSET, Shkolla e Mesme e Lartë “XHELAL HAJDA-TONI” e komunës sonë përmes DKA-së ka aplikuar në këtë program. Aktivat Profesionale të fushave kurrikulare, nën organizimin e DKA-së kanë mbajtur takimet e tyre konsultative lidhur me harmonizimin e instrumenteve të vlerësimit. Në datat 12, 13, 14, 15, 20, 21 dhe 22 Shkurt, u mbajtën 7 debate me të gjithë mësimdhënësit e 4 fushave kurrikulare, në të cilat u finalizua harmonizimi i instrumenteve të vlerësimit. U mbajtën garat shkollore të Olimpiadës Matematike në secilën shkollë, ndërsa më 23 shkurt u organizua dhe u mbajt Gara Komunale e Olimpiadës së Matematikës, ku pjesëmarrës ishin nxënësit fitues të garave shkollore nga klasat e 9, 10, 11 dhe 12. Janë mbajtur aktivitete dhe manifestime të ndryshme të organizuara nga DKA për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit. Janë përgatitur paramasat për projektet e ngrohjes qendrore në 3 shkolla dhe për drenazhimin dhe hidroizolimimin e 2 objekteve shkollore. Është vënë gurthemeli për ndërtimin e objektit të ri të shkollës në Retijë. Është hapur tenderi për projektin e ndërtimit të Shfmu “ Liria” në Fortesë, tenderi për ngrohje qendrore në 3 shkolla dhe tenderi për drenazhimin dhe hidroizolimimin e 2 shkollave. Ekipi i

psikologëve dhe pedagogëve filloi me vizitat njoftuese në disa shkolla të komunës. Nga drejtoria janë vizituar disa shkolla;

- **Në tremujorin e dytë Prill–Maj-Qershor**, kemi mbajtur një takim me përfaqësuesit e kompanisë projektuese, ku kemi biseduar për hartimin e projekteve në vazhdim. Gjithashtu, kemi patur disa konsultime me organin mbikëqyrës të projekteve. Ka filluar ndërtimi i rrethojës së shkollës “Sulejman Vokshi” në Polluzhë. Drejtoria e Arsimit së bashku me DKRS kanë organizuar mbajtjen e një shfaqjeje teatrale dhe kanë organizuar vizita të nxënësve në monumentet kulturore historike në ditën e monumenteve, më 18 prill. Kemi bërë hartimin e detyrave projektuese për 2 çerdhe. Në të gjitha shkollat vazhduan të mbahen garat shkollore me nxënës, të cilat u organizuan nga Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport. U mbajt një aktivitet pastrimi me nxënës për nder të Ditës së Tokës dhe poashtu u mbajtën 2 orë letrare me nxënës për të shënuar ditën e librit. Janë mbajtur garat komunale për kreativitet dhe mendim kritik. Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik janë marrë 4 projektet e dizajnuara për zbatimin e masave të efijencës së energjisë. Së bashku me përfaqësuesit e Zyrës së Komuniteteve kemi vizituar disa shkolla, në të cilat vijnë mësimet nxënësit e komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptas. Është organizuar dhe mbajtur me sukses Testi Gjithpërfshirës me nxënësit nga klasa 1 deri në klasën e 12 në kuadër të Garës Nacionale të Diturisë. Në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim është mbajtur ushtrimi “Simulim për mbrojtjen nga tërmetet”, në të cilin kanë marrë pjesë mbi 400 nxënës. Kemi organizuar dhe mbajtur Testin e Arritshmërisë me klasat e 9-ta dhe aktivitetin sportiv me nxënësit që kanë lindur në vitin 2008, i cili u mbajt më 27 Maj 2019. DKA dhe SHML “Xhelal Hajda-Toni” kanë nëshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), në partneritet me USAID, për të zbatuar projektin ASSET për ngritjen e Qendrës së Karrierës në SHML “Xhelal Hajda –Toni”, projekt ky i dizajnuar për të zhvilluar shkathtësitë për punësim dhe ndërmarrësi tek të rinjtë. DKA në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, organizoi disa aktivitete pastrimi të ambientit në disa lokalitete, me ç’rast këtij aktiviteti iu bashkuan edhe mësimdhënësit dhe nxënësit. Është mbajtur takim (mbledhje) me të gjitha Këshillat e Nxënësve të të gjitha shkollave, me ç’rast është zgjedhur Kryesia dhe Kryetari i ri i Këshillit të Nxënësve në nivel komunal. Drejtori i DKA-së ka marrë pjesë në prezantimin e Programit të Caritas-it Zvicëran për “Ngritjen e kapaciteteve të edukimit parafillor”, me theks të veçantë në projektin e mbështetjes dhe përkrahjes në furnizim me inventar të klasave të parafillores në shkolla. Është mbajtur pjesa e parë e testit të maturës. Drejtori i DKA-së, së bashku me mbikëqyrësin e projekteve, ka vizituar ecurinë e punimeve në ndërtimin e objektit të ri të shkollës në Hoçë të Vogël. DKA së bashku me DKRS, për nder të Ditës së Çlirimit kanë organizuar Koncert për Fëmijë, i cili u mbajt në Palestrën “Mizahir Isma”.
- **Në tremujorin e tretë, Korrik-Gusht-Shtator**, u mbajt trajnimi 6 ditësh për zbatimin praktik të planprogrameve mësimore me mësimdhënësit e 2 fushave kurrikulare, ku ishin të përfshirë 30 mësimdhënës nga Programi Fillor. Drejtoria e Arsimit ka mbajtur mbledhje me të gjithë drejtorët e shkollave për përfundimin e vitit mësimor, realizimin e planprogrameve mësimore, për suksesin e nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë dhe për ecurinë e garave nacionale të diturisë. Është bërë fasadimi dhe lysterja e mureve të jashtme të dy objekteve shkollore të shkollës “Rudolf Walther” në Dejnë dhe në paralelen e ndarë në Dodidol. Është lidhur kontrata me operatorin

“HARST GROUP” dhe kanë filluar punimet në realizimin e projektit “Drenazhimi dhe Hidroizolimi i objekteve shkollore”, i cili u zbatua në SHML “12 Maji” dhe në SHFMU “Skënder Kastrati”. Ka filluar furnizimi me lëndë djegëse (dru) për ngrohje në dimër, për të gjitha shkollat e komunës. Është organizuar dhe mbajtur orë letrare për mërgimtarët. Kanë vazhduar punët në renovimet e disa shkollave dhe poashtu ka vazhduar furnizimi i shkollave me lëndë djegëse (dru) për ngrohje gjatë dimrit. Kemi përgatitur dhe e kemi dërguar në MASHT një projekt për inventarizimin e dhomave të laboratorëve në SHML “12 MAJI”. Kemi përfunduar procesin e planifikimeve të orëve mësimore dhe kuadrit arsimor dhe është shpallur konkurs për vendet e paplotësuar. Poashtu, kemi përgatitur konkursin për regjistrimin e nxënësve në klasat e 10-a afati i dytë. Është lidhur kontrata për projektin e ngrohjes qendrore në 3 shkolla të komunës dhe menjëherë kanë filluar punimet. Kanë vazhduar punët në renovimet e disa shkollave, lysterjet e mureve të brendshme të klasave, në Shfmu “Dëshmorët e Lirisë” u bë riparimi dhe shtrimi i dysHEMEVE të koridoreve dhe klasave, në Shfmu “Dëshmorët” u bë ndërrimi i dymve të klasave. Ka vazhduar puna në instalimin e ngrohjes qendrore në 3 shkolla. Ka filluar viti i ri shkollor 2019/2020 në të gjitha institucionet parashkollore, në shkollat fillore dhe në shkollat e mesme të larta. Është bërë shpërndarja dhe furnizimi me libra në të gjitha SHFMU-të. Është vënë gurthemeli për ndërtimin e objektit të ri të shkollës fillore “Liria” në Fortesë. Është mbajtur pjesa e dytë e afatit të dytë të provimit të maturës shtetërore në të 4 shkollat. Është lidhur kontrata për meremetim dhe lysterje në Shfmu “Hamëz Thaçi” në Xërxë. Për nder të Ditës Botërore të Pastrimit, nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave të komunës sonë ju bashkangjiten aksionit të organizuar nga komuna për pastrimin e ambientit.

- **Në tremujorin e katërt, Tetor–Nëntor-Dhjetor**, janë vizituar dy objektet shkollore në ndërtim, në Hoçë të Vogël/Brestoc dhe në Retijë, ku jemi njohur me ecurinë e punimeve. Është lidhur kontrata për ndërtimin e objektit të çerdhes për fëmijë në Krushë të Madhe. Është bërë furnizimi i bibliotekave me libra në 5 shkolla të komunës. Pas kërkesës së bërë më 10 shtator në projektin “SHPRESE”, është aprovuar më 25 Tetor kërkesa e DKA-së për inventarizimin e 6 klasave parashkollore dhe përfshirjen në trajnim të 6-25 edukatoreve nga Caritasi Zviceran. Ka përfunduar furnizimi me dru dhe lëndë djegëse për shkolla para afatit të paraparë të fillimit të ngrohjes, ka përfunduar instalimi i ngrohjes qendrore në të 3 shkollat, dhe poashtu ka përfunduar projekti i efijencës së energjisë në shkollën “Vëllezërit Frashëri”. Janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme dhe është vënë gurthemeli për ndërtimin e dy çerdheve për fëmijë në fshatin Krushë e Madhe dhe në fshatin Xërxë. Është lidhur kontrata për Projektin “Ndërtimi i shkollës fillore në Kaznik”. Janë organizuar dhe mbajtur disa shfaqje teatrale për fëmijët e klasave të para deri në të pestat nga aktorët e teatrit të kukullave “DODONA”. Është vënë gurthemeli për ndërtimin e objektit të shkollës në Kaznik. Janë mbajtur dy takime me mësimdhënësit në dy Shkollat e Mesme të Larta, në SHML “Xhelal Hajda-Toni” dhe në SHML “Ukshin Hoti”. Është vizituar punishtëja ku po ndërtohet objekti i shkollës së re në fshatin Retijë, për të parë nga afër ecurinë e ndërtimit. Janë vizituar vizituar disa shkolla nga zyrtarët e DKA-së për të përcjellur mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor.

- **Synimet kryesore e DKA-së për vitin e ardhshëm janë:**
 - Themelimi dhe funksionalizimi i plotë Ekipeve për Parandalimin dhe Reagimin kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve (EPRBM) nëpër shkolla;
 - Funksionalizimi i plotë i aktivave profesionale (AP) në secilën shkollë;
 - Riparimet dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
 - Vazhdimi i investimeve në ndërtimin e çerdheve për fëmijë;
 - Vazhdimi dhe përfundimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara nga viti 2018 dhe 2019;
 - Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike dhe teknologji informative;

Avni Morina

